

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ITAL TECHNO” SH.P.K**

Ne Tirane, sot me datë 02/03/2021, me cilesine e “ortakut te vetem themelues“ :

**Znj. MARINA BRAHO** madhor e pajisur me nr **Id. I35126082T** me zotesi jurdike dhe per te vepruar, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne :

Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, kam vendosur krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **ITAL TECHNO shpk**,  
(me poshte e quajtur “Shoqeria“)

**KREU I**

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **ITAL TECHNO** shpk, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria **ITAL TECHNO** shpk , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket, te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare, ajo mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortakët gjëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne:

**Rruga Rexhep Shala , pallati Lorena 3/1 ndertesa nr 7 shkalla nr 35, Yzberisht perballe KMY,  
TIRANE.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.



Neni 4  
Objekti i veprimitarise

**Shitje me pakice dhe shumice e lendeve te para dhe produkteve parafarmaceutike dhe farmaceutike , import-eksport. Konsulence dhe marketing te produkteve farmaceutike.**

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

## **KREU II**

### **KAPITALI**

Neni 6  
Kapitali themeltar

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100, 000 Lek, i ndarë në 1 kuot.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar tërësisht nga ortaku i shoqerise:

**Znj. MARINA BRAHO**, zoterues i 1 kuotave, qe perfaqesojne 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlerë te per gjithshme 100.000 Leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.  
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat, që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërbimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 6/1  
Vlera e kapitalit deri në momentin e themelimit është 100,000 lek.

Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeve me te njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare e Biznesit për regjistrim nga administratori, në përpunje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 Për Regjistrimin e Biznesit", i

ndryshuar.

### Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

## **KREU II ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### Neni 9 Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 10  
Administrimi

Administrator i shoqerise eshte **Znj. MARINA BRAHO**

Administrator i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 3 vjecar me te drejtë riperterite.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim i asamblese se ortakeve te shoqerise.  
Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11  
Kompetencat

Administratori ka tē drejtë e detyrohet tē:

- a) kryejë tē gjitha veprimet e administrimit tē veprimtarisë tregtare tē shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, tē vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset pér mbajtjen e saktë e tē rregullt tē dokumenteve dhe tē librave kontabël tē shoqërisë;
- d) përgatisi dhe nënshkruej bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente pérpara asamblesë së përgjithshme pér miratim;
- dh) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur pér rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë tē dhënat e detyrueshme tē shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare tē Regjistrimit;
- e) Administratori ne respekt te dispozitave ligjore, mund te kryeje te gjitha operacionet qe do te jne te konsideruara nga administratori te nevojshme dhe te dobishmeper te arritur objektivat sociale aty perfshire leshimin e garancive reale dhe personale dhe besimeve edhe ndaj personave te trete.
- f) raportojë pérpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve tē posaçme me rëndësi tē veçantë pér veprimtarinë e shoqërisë tregtare;


Administratori eshte i detyruar tē thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :

Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve tē ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

kur shoqëria, brenda 2 viteve tē para pas regjistrimit tē saj, propozon tē blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më tē lartë se 5 pér qind tē aseteve tē shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare tē certifikuara,

Administratori ka tē drejtë tē kryeje tē gjitha veprimet e administrimit tē zakonshëm e tē jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë pérpara tē gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo tē huaj, autoritetete shtetërore shqiptare apo tē huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore tē gjitha shkallevë. Administratori ka tē gjitha kompetencat pér tē vepruar në marrëdhënie me tē tretët në emër tē shoqërisë, në tē gjitha rrëthanat me përjashtim tē kompetencave që ligji dhe ky statut ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me tē tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.



Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 13  
Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 14  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15  
Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise **ITAL TECHNO shpk**, u redaktua nga une "ortaku themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe me permbytje dhe vlera te njejtë juridike.

**ORTAKE E VETME E SHOQERISE  
MARINA BRAHO**

